



AKTI THEMELIMI

Per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

"RAJLI NDERTIM" SH.P.K

Sot me daten 13.11.2006 , Znj.Enkelejda COLLAKU e bija e Mehmet e dt 22.08.1970 banuese ne Durres, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, vendosen te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **"RAJLI NDERTIM" Sh.p.k** si me poshte vijon :

Neni 1

Personat fizik te siperpermendur, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pajtim me legjislacionin shqiptar, krijuan shoqerine me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K) me emertimin **"RAJLI NDERTIM" Sh.p.k.**

Ortak I vetem I kesaj shoqerie eshte Znj.Enkelejda Collaku

Administrator i kesaj shoqerie dhe drejtues teknik eshte **znj.Enkelejda COLLAKU.. me nr license Z 1776/2 dt 29.07.2002**

Shoqeria ka te drejte te krijojte filiale te saj brenda dhe jashte vendit ne çdo kohe qe do te çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqeria **"RAJLI NDERTIM " Sh.p.k,** gezon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi. **Qendra e saj eshte : L 11 ,RR Deshmoret,DURRES.**

Statuti i shoqerise i bashkengjitet ketij akti themelimi dhe eshte pjese perberese e saj.

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen : **Shoqeria "RAJLI NDERTIM"sh.p.k DURRES.**

Neni 3

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente te shtetit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

Neni 4

Shoqeria **"RAJLI NDERTIM" Sh.p.k** do te kete si objekt :

- Veprimtari ndertimore
- Investime ndertimore.
- Tregti karburanti, vajra lubrifikante me pakice
- Tregeti eksport-import, me pakice e mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, elektroshtepiake,elektronike, hidrosanitare, konfeksione, materiale ndertimi, pjese kembimi, automjete te reja dhe te perdorura etj.



- Tregeti e me shumice e pakice dyer e dritare si dhe lëndëve të para për prodhimin e mobilieve, makinerive për prodhimin dhe përpunimin e lëndës drusore si dhe pjesë këmbimi për to.
- Tregeti e lëndëve të para e materialeve dhe makinerive për industrinë e lehtë e ushqimore
- Transport kombetar dhe nderkombetar, ne menyre tokesore dhe detare, edhe per te trete.
- Agjensi shitje biletash, turistike, imobiliare
- Sherbime tregtare, komisioner.

Neni 5

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 100.000(njeqind mije) leke I paguar teresisht prej ortakut I cili merr pjese ne masen 100% ne kete kapital ,ne te drejttat dhe detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria e metejshme e shoqerise.

Neni 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie i perket ortakeve sipas perqindjeve te tyre.

Neni 7

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

Neni 8

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

Neni 9

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Themeluesi i shoqerise si e lexoi me vemendje akt themelimin e mesiperm dhe e gjeti konform vullnetit te tij e firmos pa verejtje.

ORTAKET e SHOQERISE

Enkelejda COLLAKU



S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ RAJLI NDERTIM” SHPK

KREU I

Dispozita te Pergjithshme

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “**RAJLI NDERTIM**” Sh.p.k eshte krijuar sipas kontrates se ketij statuti te perpiluar dhe nenshkruar nga ortaku I saj Znj.Enkeleida Collaku.

Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte “**RAJLI NDERTIM**” Sh.p.k.

Neni 3

Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesit te saj.

Neni 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “**RAJLI NDERTIM**” shpk ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te themeluesit dhe te punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Neni 5

Shoqeria “**RAJLI NDERTIM**” shpk eshte person juridik shqiptar, dhe fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit ne organet perkatese.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj, kontraten dhe ne kete statut.

Neni 6

Selia e shoqerise “**RAJLI NDERTIM**” shpk eshte ne L 11 Rr Deshmoret,**Durres**.

Neni 7

Administrator i shoqerise dhe drejtues teknik e ligjor eshte **znj Enkeleida Collaku, me nr license Z 1776/2 dt 29.07.2002**

Neni 8

Durres.

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen : **Shoqeria "RAJLI NDERTIM" Sh.p.k.**

Neni 9

Shoqeria ka per objekt :

- Veprimtari ndertimore
- Investime ndertimore.
- Tregti karburanti, vajra lubrifikante me pakice
- Tregeti eksport-import, me pakice e mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, elektroshtepiake,elektronike, hidrosanitare, konfeksione, materiale ndertimi, pjese kembimi, automjete te reja dhe te perdorura etj.
- Tregeti e me shumice e pakice dyer e dritare si dhe lëndëve të para për prodhimin e mobilieve, makinerive për prodhimin dhe përpunimin e lëndës drusore si dhe pjesë këmbimi për to.
- Tregeti e lëndëve të para e materialeve dhe makinerive për industrinë e lehtë e ushqimore
- Transport kombetar dhe nderkombetar, ne menyre tokesore dhe detare, edhe per te trete.
- Agjensi shitje biletash, turistike, imobiliare
- Sherbime tregtare, komisioner.

Neni 10

Shoqeria ushtron veprimtarine e vet te perçaktuar ne kete statut ne territorin e Republikes se Shqiperise. Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te çele dege, zyra dhe filiale te saj te perfaqesimit brenda dhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku eshte hapur.

Neni 11

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

Neni 12

Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon ortakun te kene pavaresi ligjore, per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

Ortaku nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tek kapitali themelor .

Neni 13

Ortaku ka keto te drejta kryesore :

- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise, ne perputhje me kontraten dhe statutin vete ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
- Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne cdo forme dhe sasi qofte ne perputhje me statutin dhe kontraten.
- Te marrin pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen, nepermjet perfaqesuesit te tyre ose vete.
- Te kerkojne ti jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen tregtare te shoqerise si dhe te gjitha dokumentet e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.
- Te bejne propozime dhe ti paraqesin ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emerojne dhe shkarkojne perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.
- Te heqin dore nga shoqeria. Heqja dore nga shoqeria nuk liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.

Neni 14

Ortaku ka keto detyra kryesore :

- Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tij, vete ose nepermjet perfaqesuesve qe krijojne ata.
- Ti japin shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryejne sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

KREU II

Kushtet ekonomike

Neni 15

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te veprimtarise kontabel dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

Neni 16

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000(njeqind mije)eke.

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi ne para i ortakut te vetem.

Neni 17

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te saj ortakut I vetem ka te drejten e rritjes se tij ne menyre proporcionale.

Neni 18

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve dhe paraardhesve e pasardhesve.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

Neni 19

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

Neni 20

Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

Shoqeria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale qe mund te linden gjate veprimtarise se saj, mbulohen nga fonde rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumet suplementare qe kur deshirojne mund te derdhen prej ortakut, ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

KREU III

Viti financiar, llogarite vjetore, ndarja e fitimit.

Neni 21

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ne ditën e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon me 31 dhjetor te vitit 2006.

Neni 22

Llogarite vjetore, inventari, raportet, operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga ortaku i vetem. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 23

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si dhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregetare etj, e perfiton 100% ortaku I vetem Znj Enkelejda Collaku .

Neni 24

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

KREU IV

Administrimi

Neni 25

Ortakët i perballojne humbjet sipas perqindjeve te pjesemarrjes se veprimtarine e shoqerise ne te ardhmen.

Neni 26

Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve. Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga Administratori, eksperti kontabel i autorizuar ose likuiduesi.

Neni 27

Sipas rëndesise se vendimeve mbledhja e asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme.

Mbledhja e zakonshme e Asamblese vendos per ceshtje te tilla si emrin ose shkarkimin e ekspertit kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, te ndarjes se fitimit.

Mbledhja e jashtezakonshme e Asamblese vendos per ceshtje te tilla si ndryshimi i statutit, zvogelimi i pjeseve te kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar, shnderrimin e shoqerise nga shpk ne forma te tjera, mbylljen e shoqerise para kohe.

Neni 28

Administrimi i shoqerise behet nga Administratori. **Ne shoqerine " RAJLI NDERTIM" shpk administrator dhe drejtuese teknike e ligjore eshte znj Enkelejda Collaku e cila emerohet ne kete post me miratimin e ortakeve te shoqerise dhe gjithashtu ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithveprimtarine e saj.**

Neni 29

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektivin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkeljet e ligjeve, te statutit, apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise

Neni 30

Te drejtat e administratorit ne shoqeri jane :

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te beje propozimet e nevojshme ne mbledhjet e asamblese, kur lind nevoja e ndryshimit te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te miratoje aktet normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijojte organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Te propozoje ne mbledhjen e asamblese per krijimin e njesive, strukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatise propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqese ato asamblese per miratim.
- Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likuidimit dhe te paraqese propozimet per miratim ne asamble.

- Te siguroje zbatimin e perpikthe te vendimeve te asamblese.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

Neni 31

Kontrolli i shoqerise mund te kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhje. Ai caktohet nga administratori i shoqerise. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ose kur behet e pamundur kryerja e detyreve.

KREU V

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise.

Neni 32

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet mbi dhjete vjet.

KREU VI

Marredheniet e punes

Neni 33

Mareveshja e punes ne shoqeri rregullohet ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionin shqiptar dhe me kete statut.

Neni 34

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet ne baze te kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje :

- Kushtet dhe menyra e marredhenieve ne pune.
- Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tyre ne vendin e punes.
- Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes.
- Puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.
- Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.
- Pushimet dhe mungesat.
- Te drejtat detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.
- Paga e punes se punonjesve, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Neni 35

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj, ne organet perkatese, duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 36

Per te gjitha mosmarreshjet, qe mund te lindin, gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Shkalles se Pare

KREU VII

Mbyllja e Shoqerise

Neni 37

Veprimtaria e shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne aktin e themelimit. Veprimtaria e shoqerise mund te mbyllet edhe kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshem veprimtaria e shoqerise nuk rezulton rentabel, ose kur ortakët heqin dore nga shoqeria.

Neni 38

Kur shoqeria likuidohet asambleja mbledh komisionin e likuidimit i cili paraqet per miratim bilancin e likuidimit te shoqerise.

Shoqeria i jep fund veprimtarise ne castine miratimit te bilancit te likuidimit.

Neni 39

Mjetet financiare si dhe cdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise kur shoqeria likuidohet, i takojne ortakut te saj te vetem ne masen 100%, pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjithë kreditorët e shoqerise.

KREU VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 40

Te gjitha veprimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahen ne seline e shoqerise

Neni 41

Ky statut eshte hartua sot me daten 12.11.2006 per shoqerine " RAJLI NDERTIM" Sh.p.k.

ORTAKU I VETEM

Enkeleida Collaku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE DURRES

Notere Ines Aleksii.Rr."A Goga".

Tel/Fax:++355 52 37730

Nr 2312 Rep. Nr 238 Kol

3

VERTETIM

Sot më datë 13.11.2006(dymije egjashte),diten e hene, në Zyrën e Noterisë Durres, u paraqit personalisht para meje noteres *Ines ALEKSI* ortakët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar " **RAJLI NDERTIM**" SH.P.K.

Znj.Enkelejda COLLAKU e bija e Mehmet e dt 22.08.1970 me pas nr Z1689350, te cilet me deklaroi se sa me siper eshte **AKTI I THEMELIMIT dhe STATUTI** te shoqerise " **RAJLI NDERTIM** "sh.p.k. konceptuar nga ajo me vullnet te plote jashte kesaj zyre noteriale dhe nenshkruar prej saj ne prezencen time, une noteria duke e gjetur sipas vullnetit të tij të lirë e të plotë *bej legalizimin sipas ligjit*

Ines V.ALEKSI

NOTERE

